

RAPORTI AUDITUSIT TE PAVARUR

Për auditimin ligjor të Pasqyrave Financiare
Të Partise Alternativa Liberale e Shqiperise
Peiudha 01/01/2011 - 31/12/2011

PËR: KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Bulevardi: "Dëshmoret e Kombit"
Pallati i Kongreseve, Tirane

Të nderuar zotërinj,

Unë, Andon Taqi Kristo, në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.06, dt.04.04.2012, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.447 prot, dt.24.05.2012, nuk kam audituar Pasqyrat Financiare të Partise Alternativa Liberale e Shqiperise, që përfshin periudhën nga 01.01.2011 deri me datë 31.12.2011

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë Alternativa Liberale e Shqiperise. Detyra e subjektit është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjin nr.8580, date 17.02.2000 "Per Partire Politike", ndryshuar me ligjin nr.10374, date 10.02.2011 dhe Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe ti paraqesë në formatin e kërkuar nga KQZ-ja.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 300.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, pasqyrën e fondeve të perfituara dhe të shpenzuara nga partia politike, aktivet dhe huatë apo linjat e kreditit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

*Unë çmtoj se **nuk** mund ta marr evidence e auditimit për të qene e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opiniononin tim të auditimit.*

Gjithashtu, megjithse vajta në Gjykatën e Tiranës për të marrë informacion për situatën aktuale të kesaj Partie, atje në regjistrin e gjykates ishte vetem rregjistrimi me keta emra: Agron Cingu, Bashkim Shkalla e Angjelina Hasani. Edhe në adresën e Partise në Rrugën "Karl Gega" nuk munda të gjej kontakt. Gjithashtu kerkova në numëtorin telefonik të Tiranës dhe nuk gjeta dot numer kontakti. Në regjistrin e gjykates nuk ka asnje veprim tjetar veç atij të rregjistrimit fillestar.

Ne keto kushte,

Une nuk mund te jap opinion per sa i takon Pasqyrave financiare te Partise Alternativa Liberale e Shqiperise".

Tirane, me 04.06.2012

Eksperti Kontabel i Regjistruar
Andon Kristo

